



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 107, Datë 26.06.2019

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË 31.05.2019, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “THIRRË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.820 MW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, pika 1 dhe 3 e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr.109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues me nr.51/10-1, datë 20.06.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s të datës 31.05.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k me vendimin nr.83, u licencua në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”.
- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.124 Prot., datë 06.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim edhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.05.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k, nuk rezultoi e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.
- Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan në seancë se do të dërgojnë në ERE një kontratë sipërmarrje e cila

justifikon çdo investim dhe vlerat monetare të vëna në dispozicion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Kontrata e Sipërmarrjes, datë 29.04.2019, “Për punime civile dhe ndërtimin e HEC Thirre”, e lidhur midis shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në cilësinë e investitorit për realizimin e projektit të ndërtimit të HEC “Thirre” dhe shoqërisë “Xhast” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit, për realizimin në sasi dhe cilësi të punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, (e depozituar në ERE nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/10, date 11.06.2019), nuk përbën dokumentacion që vërteton aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin, por përbën një detyrim financiar për t’u përmbushur nga ana e shoqërisë, nëpërmjet mjeteve financiare që ka në dispozicion.
- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k, nuk ka depozituar në ERE asnjë dokumentacion, që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për shlyerjen e kësaj kontrate dhe vijimin e investimit për ndërtimin e veprës prodhuese. Nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k në seancën dëgjimore të datës 05.06.2019, u deklarua se deklaruar shuma e vendosur si mbështetje financiare për të dy aktivitetet, vihet në dispozicion të veprimtarisë së tregëtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit nr. 83, datë 31.05.2019, ndryshon dhe bëhet:
Shoqëria “SANG 1” sh.p.k, të depozitohet në ERE:
 - 2.1. Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor nr. 97 Prot, datë 08.05.2017, përpara datës 27.04.2022.
 - 2.2. Dokumentacion që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI